



Miliarda euro nga fondet e BE-së humbasin në investime të dëmshme
 Umberto Eco: Është kultura dhe jo lufta që ngulit identitetin evropian
 Serbi – Kosovë: Arrihet Marrëveshja e shumëpritur

EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.7, Shkurt - Mars 2012

Speciale

Reformimi i Administratës Publike, parakusht për integrimin në BE!



Pas dy dekadash nga rënia e regjimit komunist, ende nuk mund të thuhet që në institucionet shqiptare funksionon një administratë publike transparente dhe meritokratike, në shërbim të qytetarit dhe zhvillimit të vendit. E kapluar nga inercia dhe pamundësia për ta ndryshuar situatën, shoqëria shqiptare ndonjëherë

harron se forcimi i kapaciteteve në administratë është jo vetëm një e mirë e drejtpërdrejtë për shoqërinë, por dhe një hap me tej drejt integrimin në Bashkimin Europian. Jo më kot, reformimi i administratës publike për të garantuar meritokraci, eficiencë dhe transparencë mbetet dhe një parakusht i rëndësishëm në kuadër të kriterit politik. Ai është një nga 12 prioritet kyçe të Opinioneve të Komisionit Europian mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE.

...vijon në faqen 2 >>

Polonia i rikujton Gjermanisë: As mos u përpiqni të bëheni hegjemonë!



Në Konferencën mbi Sigurinë, mbajtur në Mynih në shkurt 2012, u diskutua nëse Gjermania duhet të marrë një rol si hegjemon dashamirës në Europë. Por, Ministri i Jashtëm i Polonisë Radoslaw Sikorski, nuk ngurroi të shprehë kundërshtitë të fortë dhe të hapur ndaj kësaj ideje.

Pyetja e shtruar në këtë debat ishte nëse Gjermania mund të luajë një rol të ngjashëm me atë që Shtetet e Bashkuara kanë luajtur në Europë pas Luftës së Dytë Botërore. Sikorski tha se Gjermania nuk i ka atributet e një hegjemoni, si për shembull një ekonomi të madhe, një buxhet të madh ushtarak, dhe një rol ndërkombëtar proporcional me pushtetin mbizotërues rajonal.

“Pra, ju nuk do të jeni kurrë një hegjemon dashamirës në Europë dhe as nuk duhet të provoni të bëheni” ka thënë Sikorski përballë audiencës së tij, kryesisht gjermane. “Mos u dehni nga suksesi”. Ky qëndrim rihap temën e mosbesimit të vendeve si Polonia karshi Gjermanisë, një mosbesim që i ka rrënjët thellë në histori dhe kulminon me ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore.

...vijon në faqen 6 >>

Sfidat e vërteta të Greqisë



Foto : BBC

Katinka Barysch, Zv. Drejtore e Center for European Reform analizon gjendjen aktuale të Greqisë dhe sugjeron reformat strukturore si çelësin e daljes nga kriza.

Greqia kishte nevojë të dëshpëruar për një paketë të re “shpëtimi” përpara 20 marsit, datës së fundit të pagesës së borxhit prej 14.4 miliard eurosh. FMN-ja dhe qeveritë e eurozonës këmbëngulnin se paratë do t’i lëvroheshin Greqisë vetëm nëse ka një perspektivë reale që borxhi grek të bëhet i qëndrueshëm në të ardhmen, një nivel borxhi prej 120 për qind të PBB-së brenda vitit 2020. Zvogëlimi i nivelit të borxhit nga aktualitë 160, në 120 për qind kërkon shkurtim të thellë të borxhit ekzistues, kufizim të shpenzimeve shtetërore, shumë ndihmë të jashtme dhe rikthim të rritjes ekonomike.

Duke qenë në vitin e katërt të recesionit, FMN-ja dhe

...vijon në faqen 5 >>



Reformimi i Administratës Publike, parakusht për integrimin në BE!

Problemet kryesore

Vit pas viti, Progres Raportet e Komisionit Europian, si dhe Raporti Analitik 2010, i cili shoqëronte Opinion mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE, kanë vënë në pah jo pak probleme të funksionimit të administratës publike. Kryesisht, ato kanë të bëjnë me instrumentalizimin e saj nga politika, lëvizjet e shpeshta dhe të motivuara politikisht që çenojnë qëndrueshmërinë, mungesën e transparencës dhe meritokracisë në rekrutim, përdorimin e tepërt të kontratave të përkohshme, zbatimin e dobët të legjislacionit në fuqi, etj.

Ndihma e BE-së

Prej vitesh, Bashkimi Europian është angazhuar në mbështetje të drejtpërdrejtë për modernizimin e administratës publike në Shqipëri. Deri më tani, ai ka financuar, jo pak, por rreth 45 milionë euro për këtë çështje. Bashkimi Europian i ofron Shqipërisë mbështetje financiare, ekspertizë si dhe rritje të infrastrukturës, me qëllim garantimin e një administrate publike efiçente dhe transparente, në nivelin e denjë për të qenë një ditë anëtarë të BE-së.

Dëftesa e Progresit të Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian: Administrata Publike*

Sipas Vlerësimeve të Progres Raportit të Komisionit Europian

Çështjet	Raporti Analitik i Komisionit Europian 2010	Progres Raporti i Komisionit Europian 2011	Nota
Administrata publike	Kuadri i përgjithshëm ligjor administrativ dhe sistemi i shërbimit civil janë përgjithësisht në pajtim me standardet dhe parimet europiane, por disa boshllëqe ekzistojnë. Moszbatimi i kuadrit ligjor mbetet shqetësues.	Progres i pamjaftueshëm (hapa jo domethënës) për shkak se miratimi i legjislacionit relevant ka mbetur pezull si pasojë e ngërçit politik. Zbatimi i ligjeve ekzistuese dhe akteve administrative mbetet i dobët.	E-

* Për të dhëna mbi fushat e tjera, mund të konsultoni Dëftesën e plotë tek www.em-al.org



Funksionimi i administratës publike në këndvështrimin e Komisionit të Shërbimit Civil (KSHC)

Intervistë me Z. Fatmir Tafaj, Kryetar i KSHC

EuroSpeak: Aktualisht në tryezën e reformimit të administratës publike po diskutohen dy projektligje që prekin drejtpërsëdrejti (edhe pse në mënyrë kontradiktore) punën e KSHC-së, projektligji për ngritjen e gjykatës administrative, si dhe ai për statusin e nëpunësit civil. Cili është qëndrimi i KSHC-së lidhur me to?

Z. Tafaj, KSHC: KSHC vlereson se, në kuadrin e reformave në fushën administrative, ky institucion duhet të ruajë të njëjtin pozicion në kuptim të "ndërtimit institucional", duke synuar fuqizimin e rolit të tij nëpërmjet shtimit të mjeteve detyruese ligjore për të zbatuar vendimet e tij, çka pasqyrohet edhe në përmbajtjen e projekt ligjit për shërbimin civil në Shqipëri, në kapitullin ku rregullohet veprimtaria e KSHC-së. KSHC duhet të funksionojë përkrah gjykatës administrative, pasi ai vepron në një mënyrë që nuk dublon gjykatën, pavarësisht ngjashmërisë që konstatohet kur shqyrton ankesat.

Së pari, Komisioni i Shërbimit Civil duhet të vijojë të funksionojë përkrah Gjykatës Administrative, pasi ai luan rolin e mbikëqyrësit të administrimit të shërbimit civil në të gjitha institucionet që përfshihen në fushën e shërbimit civil, por sidomos në institucionet e pavarura dhe ato të pushtetit vendor, funksion të cilin nuk mund ta kryejë gjykata administrative, përveçse në mënyrë shumë të kufizuar, nëpërmjet shqyrtimit të ankesave. Ndërkohë, Departamenti i Administratës Publike është institucioni që administroshërbimin civil në institucionet e administratës qendrore. Për këtë arsye nevojitet një institucion tjetër që duhet të kryejë kontrollin se si administrohet shërbimi civil nga ky institucion, pasi këtë nuk mund ta bëjë gjykata, e cila vepron vetëm brenda objektit të kërkesë padisë. Edhe më e ndjeshme është nevoja e KSHC-së, si institucion në vartësi të Kuvendit të Shqipërisë, në rastin e mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura dhe atyre të pushtetit vendor, në kushtet kur çdo institucion tjetër kontrolli administrativ, mund të sjellë probleme lidhur me cënimin e pavarësisë së kësaj kategorie institucionesh.

Funksioni i mbikëqyrjes nuk mund të pushojë së ekzistuari për asnjë arsye, pasi çdo sistem i shërbimit civil ka nevojë për një funksion mbikëqyrjeje, i cili do të sigurojë një **uniformitet në zbatimin e legjislacionit** në pjesët e ndryshme të shërbimit civil si dhe mbi administratën territoriale dhe rajoneve të ndryshme. Nisur nga praktika e

deritanishme e punës së KSHC-së, rezultojnë nga ana e administratës mungon vullneti për të zbatuar vendimet e KSHC-së. Kjo pasqyrohet në faktin që pothuajse të gjitha vendimet e KSHC-së ankimohen në rrugë gjyqësore dhe zbatohen vetëm kur vendimi është lënë në fuqi dhe ka marrë formë të prerë në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet zyrës së përmbartimit, madje pritet edhe përfundimi i procesit në Gjykatën e Lartë.

Së dyti, në vijim të punës së tij, KSHC duhet të vazhdojë të kryejë detyrat e tij funksionale edhe në aspektin e *trajtitimit dhe zgjidhjes së ankesave të nëpunësve civilë*. Kjo për faktin se, sipas projekt ligjit për gjykatën administrative, i cili është në fazën e miratimit në Kuvendin e Shqipërisë, në kuadrin e reformave në drejtësi, kompetencat e gjykatës administrative rezultojnë shumë të gjera, pasi përfshijnë që nga problemet administrative të biznesit, e deri tek zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës, në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Komisioni i Shërbimit Civil tashmë është një strukturë e specializuar, çka ndikon në shpejtësinë e hetimit administrativ dhe njëkohësisht në zgjidhjen me cilësi të ankesave. Këtu e ka bazën dhe përqindja e lartë e vendimeve të KSHC-së, (për çdo vit ka qenë afro 95%), të cilët janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Ritmi i lartë i zhvillimeve në administratën publike, i cili është specifik në këtë rast, pasi ndonjëherë ka ndryshime të tilla, të shpejta, si ndryshimi i strukturës organizative të institucionit, pra procese që nuk mund të presin zhvillimin e një procedure gjyqësore që karakterizohet nga kohëzgjatja, përforcon nevojën për të pasur një organ administrativ si KSHC, i cili kontakton direkt me administratën, pa pasur nevojë për ankesë, për të zgjidhur shpejt dhe mirë problemet që lindin në këto raste.

Nisur nga sa analizuam me sipër, Komisioni i Shërbimit Civil, çmon se ligji për gjykatën administrative duhet të diskutohet në të njëjtën kohë me ligjin për shërbimin civil, me qëllim



Karikatura: Rael Hoxha



...vijon nga faqja 3 >>

që të përcaktohen qartë kompetencat dhe fusha e veprimit të gjykatës administrative dhe Komisionit të Shërbimit Civil.

EuroSpeak: Si do ta vlerësonit nivelin e përfshirjes së KSHC-së nga institucionet përgjegjëse në hartimin e nismave ligjore, planeve si ai mbi 12 prioritetet e BE-se apo dokumenteve të tjera?

Z. Tafaj, KSHC: KSHC për herë të parë gjatë gjithë veprimtarisë së tij, ka marrë pjesë aktive, duke bërë propozime konkrete në hartimin e plan veprimit për zbatimin e rekomandimit të 6 të BE, për reformën në administratën publike shqiptare. Me interes përmendim diskutimet lidhur me "Pyetjet" nga ana e BE-së mbi "pozicionin e KSHC-së në frymën e Projektligjit të Gjykatës Administrative". Opinione të KSHC-së në lidhje me këtë diskutim, si edhe planet konkrete të hartuara për monitorimin e shërbimit civil, iu dërguan Ministrisë së Brendshme, si institucioni i ngarkuar për të drejtuar procesin në këtë rast. Gjithashtu, ky material u diskutua dhe në takimin që KSHC ka realizuar me përfaqësues të BE-së në Tiranë. Në këtë kontekst KSHC ka paraqitur opinionin e saj lidhur me këtë pozicion dhe shpresoj që ky opinion do të pasqyrohet ashtu si dhe është paraqitur nga ne.

EuroSpeak: Ju lutem, a mund të na jepni të dhëna dhe një vlerësim mbi zbatimin e vendimeve të KSHC-së vitin e fundit?

Z. Tafaj, KSHC: Duke analizuar të dhënat e grumbulluara në fazën e verifikimit të zbatimit të vendimit paralajmëruar dhe duke i krahasuar me konstatimet e bëra në momentin e mbikqyrjes, vihet re se **1)** ka një reagim pozitiv në drejtim të uljes së numrit të marrdhënieve të punës me kontratë dhe përmendim si shembull, *Ministrinë e Mbrojtjes*, ku nga **55** raste të konstatuara gjatë mbikqyrjes, janë vetëm **9** raste në momentin e verifikimit, po kështu edhe në *Ministrinë e Mjedisit*, ku nga **17** raste në momentin e mbikqyrjes, pas verifikimit janë vetëm **4** raste, etj. Por, konstatohen edhe raste ku institucioni nuk ka reaguar në këtë drejtim dhe përmendim këtu *Ministrinë e Arsimit* që ka pasur **10** raste të emërimeve me kontratë dhe e njëjta situatë gjendet edhe pas përfundimit të afatit të paralajmërimit. Në këtë rast, të gjitha kontratat janë lidhur nga titullari i institucionit, pa miratimin e DAP, ndërkohë që pa këtë miratim kontratat nuk mund të marrin fuqi ligjore. Nga një pikpamje, situata e përgjithshme që paraqitet më sipër, në lidhje me rekrutimin, mund të vlerësohet si një arritje e cila duhet të evidentohet. Por, nga ana tjetër, nuk mund të mos vemë në dukje faktin që, janë shpallur të lira e janë kryer procedurat formale të konkurimit duke dale dhe akti i emërimit, për atë person që kishte të lidhur më

parë marrdhënieve të punës me kontratë, për atë vënd pune. Përpjekje konkrete pozitive për të rregulluar situatën, vihen re sidomos në grumbullimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të nëpunësit civil, të përfshirë në dosjen e personelit.

Situata e zbatimit të vendimeve të marra gjatë shqyrtimit të ankesave, rezulton e tillë: 1. Vendime të marra nga KSHC gjatë vitit 2011 -**261**; 2. Nga këto, ankesa të pranuar - **92**; 3. Nga këto, vendime të marra gjatë vitit 2011, të zbatueshme për shkak se ka përfunduar gjykimi në Apel, aktualisht të pazbatuara - **30**; 4. Vendime të vitit 2011 që janë mbartur për shqyrtim në vitin 2012, nga gjykatat e apeleve (pa përfunduar) - **45**; 5. Vendime të zbatuara nga institucionet, vullnetarisht, për vitin 2011 (vetëm për masa disiplinore: vërejtje) -**17**. Pjesa tjetër e vendimeve të komisionit, siç e kemi thënë më lart, përbëhet nga **29** raste pranime të pjesëshme dhe **62** raste rrëzim ankese, të cilat janë kryesisht në ndjekje nga të interesuarit në gjykatën e rrethit, për qëndrimin e të cilës nuk mund të konkludojmë pa përfunduar gjykimi në shkallë të dytë dhe **43** raste pushim shqyrtimi për shkak inkompetence. Pjesa tjetër është e përbërë nga **22** raste pushimi për heqje dorë, mungesë objekti, etj dhe **13** vendime mungesë *quorumi*.

Një dëm efektiv i konsiderueshëm është shkaktuar në buxhetin e shtetit, pasi janë paguar njëkohësisht dy persona për një pozicion pune, njëri për shkak të detyrimeve kontraktuale dhe tjetri për shkak të detyrimit për të ekzekutuar vendimin e gjykatës. Për të gjitha këto raste KSHC ka njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Disa prej institucioneve, në pretendimet e tyre për mosekzekutimin e vendimeve të KSHC-së, nxjerrin si justifikim faktin se vendimet bëhen të pamundura për tu ekzekutuar, pas ezaurimit të rrugës gjyqësore për shkak se, ndërkohë kanë ndryshuar rrethanat objektive që kanë determinuar momentin e shqyrtimit të çështjes nga KSHC, të tilla si, përfshirja e institucionit në procese ristrukturimi, që sjellin si pasojë shkurtimin e pozicioneve ose riorganizimin e tyre.

Kjo tregon se ky mjet, pra mjeti i vetëm që i është dhënë Komisionit të Shërbimit Civil, për të rregulluar ligjshmërinë, nëpërmjet çeljes së proceseve gjyqësore apo për të siguruar ekzekutimin e vendimeve të tij, nuk është efikas. Ky moment duhet të rregullohet nëpërmjet ndryshimeve ligjore me qëllim që të forcohet roli i KSHC, duke i dhënë instrumentet e duhura ligjore për vendosjen e sanksioneve në rast moszbatimi të vendimeve të tij.

Stafi i EuroSpeak, shkurt 2012

Sfidat e vërteta të Greqisë

...vijon nga faqja 1 >>

donatorët e huaj janë të vetëdijshëm se Greqia nuk është në gjendje të nxjerrë më shumë të ardhura nga ekonomia e saj. FMN-ja parashikon një ulje të PBB-së me 3 për qind gjatë këtij viti, ndërsa parashikuesit e sektorit privat, si Economist Intelligence Unit, pretendojnë dyfishin e kësaj vlere.



Theksi i bisedimeve të Greqisë me trojkën (FMN, Banka Qendrore Europiane dhe Komisioni European) është zhvendosur mbi reformat strukturore të hartuara për nxitjen e zhvillimit. Lajmi i mirë është se duke qenë ekonomia më pak efikase e BE-së, implementimi i reformave gjithëpërfshirëse mund të rrisë normën vjetore të rritjes ekonomike. Lajmi i keq është se shumica e këtyre reformave deri tani ekzistojnë vetëm në letër dhe janë të mbushura me defekte. Në shumë raste, pengesa më e madhe për përparimin e vërtetë është administrata e fryrë dhe joefikase. Sipas një analize të OECD publikuar në dhjetor, qeveria qendrore thjesht nuk është e aftë për hartimin dhe zbatimin e reformave për të cilat Greqia ka dëshpërimisht nevojë.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) raporton se në Greqi numërohen rreth 390.000 nëpunës civilë. Duke shtuar edhe 660.000 në korporatat publike dhe subjekte të tjera gjysmë-shtetërore, numri kalon 1 milionë, më shumë se një e pesta e fuqisë punëtore. Numër që mund të jetë shumë i ulët pasi ka shumë nëpunës kuazi-civilë, me kontrata të përkohshme, që gëzojnë nivele pagash të nëpunësit civil me të drejta të plota. Punonjësit e sektorit publik, përpara krizës, kanë pasur paga mesatarisht 60-70 për qind më të larta se sektori privat dhe gëzonin shumë përfitime shtesë, përveç se e kishin të sigurt punën. Sipas Institutit Kombëtar të Punës në Greqi, që nga fillimi i krizës, shpenzimet e punës në administratën publike, të mbrojtjes dhe të sigurisë sociale kanë rënë me rreth 6 për qind. Në disa pjesë të sektorit privat, si hotele dhe restorante, kostot e punës kanë rënë me 30 për qind, dhe kryesisht ky sektor është goditur nga papunësia.

Një nga kërkesat e trojkës, ka qenë tkurrja e sektorit publik duke zëvendësuar një nga pesë punonjës të dalë në pension. Por mes fillimit të 2010 dhe mesit të 2011, qeveria shtoi 20.000 njerëz në listën e pagave të sektorit publik (i cili ende përbën 13 për qind të PBB-së). Tani trojka këmbëngul që qeveria të marrë masa serioze në lidhje me shkurtrimin e numrit deri në

150.000 gjatë tre viteve të ardhshme.

Raporti i OECD për dhjetorin zbulon se problemi i administratës greke nuk janë përmasat e saj, por vlera e shtuar që është shumë e ulët. Impakti i politik-bërjes është shumë i vogël sepse burokracia ministrore nuk bazon hartimin e politikave mbi mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave. Komunikimi midis ministrive është mjaft i dobët. Brenda ministrive, departamentet prodhojnë rregulla dhe norma pa pasur dijeni si ato mund të përshtaten me planet e politikave të gjera. Një ministri greke ka mesatarisht 440 departamente ose njësi administrative, ku një ndër pesë e këtyre kanë vetëm drejtorin si staf, dhe vetëm një ndër dhjetë kanë më shumë se 20 punonjës. OECD përfundon se Greqia ka një administratë tej mase të fryrë dhe të paqëndrueshme, e cila në thelb është e zënë duke "bashkëbiseduar me vetveten".

Në mënyrë të ngjashme, një studim i London Business School vitin e kaluar, tregon nevojën e një fillimi të ri në disa zona të administratës greke. Autorët sulmojnë korrupsionin që karakterizon sektorin tatimor. Edhe ish-zyrtarë të ministrisë së financave pranojnë se do të ishte në të mirë të Greqisë shfuqizimi i 300 zyrave tatimore lokale, pasi kushtojnë më shumë se ajo që mbledhin. Në vend të kësaj, Greqia duhet të ngriejë një agjenci qendrore të pavarur për mbledhjen e taksave dhe sigurimeve shoqërore. Studimi sugjeron ngritjen e organeve të ngjashme të pavarura edhe në fusha të tjera, pasi mund të krijohen shpejt dhe mund të bëjnë ndryshimin.

Ditët në vazhdim, presioni në rritje nga politikanët e BE-së nxiti parlamentin Grek që më 13 shkurt miratonte paketën e re me shkurtime buxhetore shtesë prej 3.3 miliard eurosh për vitin 2012. Masë kjo e kërkuar nga BE dhe FMN, për t'i lëvruar Greqisë këstin e dytë të shpëtimit prej 130 miliard eurosh dhe për të shmangur falimentimin kombëtar. Ky event solli protesta të shumta dhe të dhunshme në Athinë, ku u plaçkitën 150 dyqane dhe iu vu flaka 34 godinave.

Sipas kritikëve kjo paketë, e cila përfshin ndër të tjera edhe reduktimin e pagës minimale me 22 përqind, e dënon ekonominë greke të futet akoma më thellë në mjerimin e saj.

Stafi i EuroSpeak, janar 2012

Kartolina nga BE-ja

Polonia i rikujton Gjermanisë: As mos u përpigni të bëheni hegjemonë!

...vijon nga faqja 1 >>

Duke u ndalur më tej tek atributet e munguara të Gjermanisë lidere në Europë, Sikorski kujtoi: “Ekonomikisht, Gjermania është vetëm pak më e madhe sesa Franca dhe Britania, ndërsa ekonomia e Shteteve të Bashkuara i la shumë mbrapa rivalët e saj kur ajo u bë një fuqi botërore. Gjithashtu, tregtia gjermane është e lokalizuar kryesisht në Europë. Pa përmendur këtu dhe buxhetin e shpenzimeve ushtarake që mbetet modest”.

Megjithatë, Sikorski i ofroi me mirësjellje ndihmë Gjermanisë në rolin e saj si vendi më i madh, dhe ndoshta ai me fuqi dominuese në Europë.

“Polonia është e gatshme që në baza pragmatike dhe pavarësisht nga historia, t’ju ndihmojë” u shpreh Sikorski. “Për sa kohë që ne punojmë të gjithë drejt zgjidhjeve europiane.”

Foreign Policy, 3 shkurt 2012

Mbretëria e Bashkuar: Do të forcohen ligjet mbi skrapin për të luftuar vjedhjen e metaleve



Pagesat me para në dorë për hekurishtet do të bëhen të jashtëligjshme dhe gjobat do të rriten në mënyrë të konsiderueshme për

të trajtuar problemin e vjedhjes së metaleve.

Industria e riciklimit të metaleve ka një vlerë prej 5.6 miliard sterlina dhe punëson 8.000 njerëz në Britaninë e Madhe.

Thirrjet për veprim kanë qenë në rritje me vjedhjet e shumta në hekurudha gjatë viteve të fundit, të cilat vetëm vitin e kaluar kanë pasur një kosto prej 16 milion sterlinash dhe kanë shkaktuar çrregullime

për 3.8 milion pasagjerë. Simbolet në çatitë e disa kishave janë vjedhur dhe bakri është marrë nga kabinat telefonike dhe kantieret e ndërtimit.

Parlamentarja Yvette Cooper, mirëpriti propozimet për rritjen e gjobave. Por ajo shtoi se policia ka nevojë për më shumë kompetenca për të hyrë në oborret e hekurishteve dhe për të ndaluar tregtinë e paligjshme. Në fjalën e saj, Znj. Cooper kritikoi qeverinë për mungesë serioziteti mbi këtë çështje. Vetëm vjedhjet e telave kanë vënë jetë në rrezik pasi kanë zhytur komunitetin në errësirë për shkak të ndërprerjeve të vazhdueshme të energjisë elektrike. Ajo i bëri thirrje kryetares së komitetit parlamentar përgjegjës për të paraqitur propozime më të ashpra javën në vijim në parlament.

BBC, 26 janar 2012

Protestat sjellin një kryeministër të ri për Rumaninë

Pas një zemërimi të thellë popullor që shkaktoi dorëheqjen e kryeministrit Emil Boc, parlamenti rumun miratoi më 9 Shkurt një qeveri të re, e cila do të udhëhiqet nga ish-shëfi i inteligjencës së huaj, Mihai Razvan Ungureanu. Ndërkohë Basescu, do të vazhdojë të jetë presidenti i Rumuanisë. Kryeministri i ri, Ungureanu ka premtuar se do të mbajë rregulla të ashpra në mënyrë që vendi të mund të përfitojë kredi ndërkombëtare për të rritur pagat e sektorit publik sa më shpejt që mundet. Nën drejtimin e tij, koalicioni qeverisës mbetet në parlament me një shumicë të ngushtë, 237 nga 463 vende në total. Paraardhësi i tij, Emil Boc dha dorëheqjen pas 20 ditëve protestash në mbarë vendin mbi masat shtrënguese dhe rënien ekonomike. Ai e justifikoi vendimin e dorëheqjes me qëllim uljen e tensionit social dhe mbrojtjes së stabilitetit ekonomik.

Stafi i EuroSpeak, shkurt 2012

...vijon në faqen 6 >>

Ligji i ri i BE-së i jep përdoruesve “të drejtën për tu harruar”



Komisioni Europian ka zbuluar një ligj të vetëm për gjithë BE-në për sa i përket ruajtjes së të dhënave dhe privacisë në internet.

Draft rregullorja përshtat një ligj të vitit 1995 me ditët e sotme, ku 250 milion qytetarë të BE-së përdorin internetin çdo ditë.

Ligji i jep qytetarëve të “drejtën për tu harruar” duke detyruar kompani të tilla si Facebook ose Amazon të heqin informacionet personale nga interneti apo nga serverat e tyre. Gjithashtu, i jep përdoruesve të drejtën për të hequr të dhënat e tyre nga një kompani dhe për t’ia dhënë një tjetre.

Nga ana tjetër, firmat duhet të kërkojnë miratimin e personave në se ata do t’i përdorin informacionet e tyre për veprime të tilla si fushata marketingu apo të tjera. Ata gjithashtu do të duhet të njoftojnë personat dhe autoritetet kombëtare brenda 24 orëve nëse ka shkelje të sigurisë. Nëse drafti miratohet në formën e tij aktuale, atëherë ai do të ndikojë çdo kompani në botë që bën biznes online me BE-në.

Gjobat për pa-pajtueshmëri fillojnë nga 250.000 euro deri në 0.5 për qind e xhiros nëse, për shembull, një firmë tarifon një person i cili kërkon të aksesojë të dhënat e tij, nga 500.000 euro deri në 1 për qind të xhiros nëse firma refuzon t’i japë të dhënat personale përdoruesit dhe 1 milion euro, ose 2 për qind të xhiros, për shkelje të rënda si shitja e të dhënave të personave pa miratimin e tyre.

Komisionerja për Drejtësinë në BE, Viviane Reding, tha se ligji do jetë praktik për kompanitë dhe do ulë kostot e tyre, pasi do jetë një rregullore për gjithë bllokun. Sipas statistikave, pajtueshmëria e firmave me setin e 27 juridiksioneve mbi këtë çështje, shpërdoron 130 milionë euro në vit.

EUobserver, 25 janar 2012

Miliarda euro nga fondet e BE-së humbasin në investime të dëmshme



Një hartë tregon projektet e dëmshme nga ana ekologjike dhe shoqërore në Europën Qendrore dhe Lindore.

Sipas një studimi të dy organizatave me qendër në Bruksel, Friends of the Earth Europe dhe CEE Bankwatch Network, disa projekte në zbatim, me kosto miliarda eurosh nga fondet e BE-së shkaktojnë dëme të konsiderueshme mjedisore dhe sociale. Ato kanë evidentuar gjithsej 33 projekte të dëmshme në Europën Qendrore dhe Lindore, me një kosto totale prej 16 miliardë eurosh. Projektet, të cilat përfshijnë rrugë që kalojnë nëpër zona natyrore të mbrojtura, fabrika të përpunimit të mbeturinave dhe aeroporte, po financohen ose po merren në konsideratë për tu përkrahur financiarisht në të ardhmen nga fondet e Politikës së Kohezionit në buxhetin aktual të BE-së 2007 – 2013. Harta përfshin projekte nga Bullgaria, Estonia, Maqedonia, Hungaria, Republika Çeke, Sllovakia dhe Polonia.

Projektet do të shkaktonjë dëme të tilla si rritje të ndotjes, humbjen e biodiversitetit, rritje të rrezikut të përmytjeve, si dhe zhvendosjen e komuniteteve lokale të banorëve. Për ekspertët e këtyre organizatave, paratë nuk duhet të shpenzohen në investime të tilla të paarsyeshme. Është e rëndësishme që buxheti i ardhshëm i BE-së të ofrojë mundësitë për tejkalimin e krizës aktuale dhe ngritjen e ekonomive të gjelbra.

Stafi i EuroSpeak, shkurt 2012

Umberto Eco: Është kultura dhe jo lufta që ngulit identitetin evropian



I pyetur për të përshkruar identitetin evropian në vitin 2012, Eco thotë se “Identiteti evropian është i përhapur, por i cekët. Ne duhet ta ndryshojmë këtë, para se kriza ta zhveshë



Në pritje të aderimit...

Shumë zhurmë për asgjë: Marrëveshja mes Shqipërisë dhe Kosovës rindez dyshime anakronike

Europën nga çdo gjë. Programet universitare të shkëmbimit si Erasmus kanë krijuar gjeneratën e parë të europianëve të rinj. Unë e konsideroj atë një revolucion seksual. Erasmus-i duhet të jetë i detyrueshëm jo vetëm për studentët, por edhe për shoferët e taksive, hidraulikët dhe punëtorët e tjerë. Me këtë, dua të them se ata duhet të kalojnë kohë në vende të tjera brenda BE-së, pra duhet të integrohen

Kur unë e propozova këtë ide në një takim të kryetarëve të bashkive të BE-së, kryebashkiaku i Uellsit tha: "qytetarët e mi kurrë nuk do ta pranojnë këtë!" Dhe kur sërish fola në lidhje me këtë çështje në një televizion anglez, unë u qortova nga drejtuesi i emisionit, i cili ishte i shqetësuar për krizën e euros, për Europën mbikombëtare si dhe qeveritë teknike në Greqi dhe Itali që nuk ishin "zgjedhur" nga populli dhe për këtë arsye janë "jodemokratike". Por edhe para krizës së borxhit, identiteti i Europës ishte i dobët. Europa është një kontinent që ka qenë në gjendje të bashkojë identitete të shumta pa i ngatërruar ato. Kjo është pikërisht se si unë e shoh të ardhmen e saj. Me të gjitha defektet e tij, tregu global e bën luftën më pak të ngjarë, madje edhe në mes të SHBA dhe Kinës, Europa kurrë nuk do të jetë Shtetet e Bashkuara të Europës, një vend i vetëm me një gjuhë të përbashkët si në SHBA. Në të vërtetë, ne kemi shumë gjuhë dhe kultura, ndaj ideja e një gazete europiane unike është tani për tani vetëm një utopi. Por pavarësisht kësaj interneti na ka bërë të vetëdijshëm për të tjerët. Unë ende mendoj se nuk ka më një pabarazi midis Lisbonës dhe Varshavës, ashtu si nuk ka ndryshim midis San Franciskos dhe Nju Jorkut. Ne do të mbetemi sërish një federatë, por e qëndrueshme. Pra, cilat fytyra duhet të printojmë në kartëmonedhat tona, për t'i kujtuar botës se ne nuk jemi thjesht Europeanë të "cekët", por të thellë? Ndoshta jo politikanë apo liderë të cilët na kanë ndarë, por njerëzit të kulturës të cilët na kanë bashkuar, nga Dante tek Shekspiri, nga Balzaku tek Rossellini.

The Guardian, 26 janar 2012

Më 20 tetor 2011 kabineti qeveritar shqiptar aprovoi një marrëveshje të unifikimit konsullor jashtë vendit midis Kosovës dhe Shqipërisë. Marrëveshja mundëson dhënien e shërbimeve konsullore për qytetarët kosovarë në ato vende ku Shqipëria ka përfaqësi diplomatike dhe Kosova jo. Në fjalën e tij, Z. Berisha foli për bashkëpunime të mëtejshme për të zvogëluar sa më shumë barrierat burokratike për qytetarët e Kosovës dhe Shqipërisë.

Lajmi nuk u prit mirë nga opinionistët dhe politikanët ballkanas dhe mjaftoi për të ringritur çështjen e "Shqipërisë së Madhe". Një ekspert i diplomacisë maqedonase i vlerëson bashkëpunimet diplomatike dhe ekonomike si hapin e parë të përpjekjeve të Kosovës dhe Shqipërisë për të sjellë në jetë synimet e Lidhjes së Prizrenit të 1878-ës. Nga ana tjetër, duke insistuar se Kosova është protektorat i OKB-së, zëdhënësi i qeverisë serbe, Milivoje Mihajlovic tha se Beogradi nuk mund të pranojë nisma që nuk janë në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244.

Duhet pasur parasysh se të tilla marrëveshje mbi shërbimet konsullore janë një praktikë e përhapur në diplomaci. Për shembull, Serbia ka nënshkruar të njëjtën marrëveshje me Malin e Zi, pak pas shpalljes së pavarësisë së këtij të fundit në vitin 2006.

Stafi i EuroSpeak, shkurt 2012

Kroacia "sforcohet" për të shpenzuar paratë e BE-së

Gjykata Europiane e Auditorëve ka deklaruar se "vështirësi të mëdha" janë duke penguar përdorimin e parave nga shteti më i ri që do t'i bashkohet BE-së në vitin 2013.

Ndihma e para-anëtarësimit dhënë Kroacisë nga buxheti i BE-së gjatë periudhës 2007-2013 rezultoi të jetë rreth 1 miliard euro. Një pjesë e madhe e

saj është projektuar për zhvillimin rural (25 milion euro në ndihmë rurale që nga viti 2007; në shumën e 184 milion euro në periudhën 2007-2013). Auditorët zbuluan se vetëm një e treta e 51 milion eurove të akorduara për programet e viteve 2007 dhe 2008 ishin miratuar në maj të 2011, edhe pse ndihma duhej shpenzuar deri në fund të këtij viti. Auditorët paralajmërojnë se vonesa të tilla do të kenë efekte mbi aftësinë e vendit për të absorbuar ndihmën që do të vijojë pas bashkimit me BE-në në korrik të 2013. Si rezultat i nivelit të ulët të përthithjes, fermerët dhe agro-përpunuesit kroatë nuk janë ende familjarizuar me procedurat e financimit të BE-së përmes “të mësuarit duke bërë” si ishte menduar - thotë raporti i Auditorëve. Auditorët theksojnë se Kroacia ende përballet me “sfida të rëndësishme” për sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe se politikat e tyre të prokurimit kërkojnë “vëmendje të konsiderushme”.

EuropeanVoice, 1 shkurt 2012

Aborti selektiv në Shqipëri ende i përhapur



Në qoftë se është djalë, gjithçka është në rregull. Në qoftë se është vajzë, ka një dilemë.

Sipas Këshillit të Europës, në Shqipëri raporti i lindjeve vajza-djem është 100-112, një shifër mjaft e shpërpjesëtuara në krahasim me raportin e rritjes demografike natyrore.

“Shpresoj të jetë djalë, sepse do t’i sjellë familjes fat. Një vajzë nuk është mirë. Në qoftë se është një vajzë, atëherë vendimi i takon familjes. Për mua nuk do ishte ndonjë tragjedi. Këto gjëra janë të rëndësishme”. Këto janë fjalët e një gruaje shtatëzënë intervistuar në ambientet e maternitetit të Tiranës mbi abortin selektiv.

Sipas një sociologeje, ky nuk është një fenomen i ri. “Në sistemin tradicional patriarkal, vajzat lindin për t’iu dhënë një burri, dhe për këtë arsye janë

në një farë mënyre persona të jashtëm të familjes. Tradicionalisht ato nuk e mbajnë mbiemrin e familjes. Nëse një familje ka vetëm vajza, mendohet se familja do të zhduket” - shpjegon ajo.

Në vitet '60, ky problem ishte përfshirë në fushatën e Enver Hoxhës për ç’rrenjosjen e traditave reaksionare. Ekspertët pranojnë se ky fenomen shkoi drejt zhdukjes gjatë periudhës së komunizmit, por duket se dobësimi i institucioneve që erdhi me tranzicionin, krijoi baza për rikthimin e tij në shoqëri. Shqipëtarët që jetojnë në qytete të mëdha tentojnë ta klasifikojnë çështjen si tipike e krahinave të prapambetura veriore. Megjithatë, shumica e aborteve ndodh në qytete, sidomos në Tiranë.

Sipas ligjit, aborti lejohet deri në javën e 12-të të shtatzanisë, afat mjaft i vështirë për të përcaktuar seksin e fetusit. “Kjo pengesë mund të tejkalohet. Është e mjaftueshme të marrësh një justifikim mjekësor, që të përcaktojë një arsye të pranueshme ligjërish për ta lejuar abortin. Nuk është e vështirë të demonstrosh nevojën për abort për shkak të diabetit apo shëndetit mendor të nënës” - tregon një doktoreshë në këtë fushë. Sipas raporteve mbi korrupsionin në Shqipëri, mjekët vazhdojnë të ruajnë pozicione kryesuese në listën e profesioneve më të korruptuara. Një nga përpjekjet për zgjidhjen e këtij problemi vjen nga Këshilli i Europës, i cili sugjeron ndalimin e zbulimit të seksit të fetusit nga mjekët. Por, mjekët në Tiranë janë të ndarë mbi këtë çështje, pasi shumë prej tyre e konsiderojnë atë si shkelje të të drejtave të prindërve.

Disa javë pas publikimit të raportit alarmant nga Këshilli i Europës, aborti selektiv u zhduk nga faqet e shtypit shqiptar, pa asnjë reagim nga ana e institucioneve që duhet të merren me këtë çështje.

Osservatorio Balcani e Caucaso, janar 2012

Josipovic kërkon arbitrazh me Serbinë dhe Bosnjen

Në qoftë se nuk arrihet në një marrëveshje brenda afateve të caktuara, Presidenti kroat propozon arbitrim për zgjidhjen e problemeve kufitare të

Kroacisë me Bosnjën dhe Serbinë. Sipas tij arritja e marrëveshjeve bilaterale, pa ndihmën e një partneri të tretë do të jetë më e shpejtë dhe me kosto më të ulët se procesi i arbitrimit mbi të cilin ranë dakord Sllovenia dhe Kroacia në Shtator 2009.

“Secila palë mund të propozojë dy gjyqtarë arbitrazhi dhe të bien dakord mbi të pestin. Pas kësaj, të dy vendet duhet të deklarojnë se do të pranojnë çdo rezultat.” - propozon presidenti.

Në vitin 2002, Kroacia dhe Mali i Zi ranë dakord për një regjim të përkohshëm mbi pjesën e kontestuar të kufirit, pranë Prevlakës në jug të Kroacisë. Që atëherë, të dy vendet kanë treguar gatishmëri për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mbetura kufitare në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, në Hagë dhe në Gjykatën Ndërkombëtare mbi Ligjin e Detit. Nga ana tjetër, Kroacia dhe Serbia duhet të bien dakord mbi disa pika kufiri të përbashkëta, sidomos mbi më të komplikuarën, atë mbi lumin Danub.

Në fund të negociatave të saj me BE-në, Kroacia deklaroi të nuk do të bllokojë procesin e pranimi në BE të fqinjëve të saj për shkak të mosmarrëveshjeve dypalëshe, siç Sllovenia dikur bllokoji Kroacinë mbi çështjet kufitare, ose siç Greqia vazhdon të bllokojë Maqedoninë për shkak të çështjes së pazgjidhur rreth emrit të kësaj të fundit.

BalkanInsight, 08 shkurt 2012

Serbi – Kosovë: Arrihet Marrëveshja e shumëpritur

Përfaqësuesja e Lartë e diplomacisë Europiane, Katherine Ashton dhe Komisioneri për Zgjerim Stefan Fule, kanë përshëndetur marrëveshjet e arritura më 24 shkurt mes Serbisë dhe Kosovës në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe menaxhimit të integruar të pikave të kalimit kufitar. “Këto marrëveshje janë një hap i madh përpara jo vetëm për Serbinë dhe Kosovën, por për stabilitetin e rajonit dhe në këtë mënyrë për vetë BE-në” – citohet në deklaratën e dy zyrtarëve të lartë europianë.

Këto marrëveshje priten të sjellin përfitime të dyanshme. Për sa i përket Serbisë, këto marrëveshje

janë veçanërisht të mirëpritura para vendimit të javës që vjen të Këshillit, për dhënien e statusit kandidat. Më 23 shkurt Franca, Gjermania dhe Austria i kanë dorëzuar baroneshës Ashton një deklaratë të përbashkët në favor të dhënies së statusit të kandidatit Serbisë, kjo si një shpërblim për angazhimin dhe përpjekjet e theksuara të saj gjatë kohëve të fundit.

Lidhur me Kosovën, këto marrëveshje e bëjnë atë pjesëmarrëse me të drejta të plota në takimet dhe aktivitetet rajonale dhe mundësojnë përparim të mëtejshëm drejt marrëdhënieve kontraktuale me BE-në. Por, mbartet një sakrificë. Vendi do të emërtohet Kosovë, me asteriks, dhe shpjegimi plotësues do të jetë: Ky emërtim nuk paragjykon statusin e Kosovës dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të OKB-së dhe me Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës. Në këtë mënyrë, mendohet se Kosova do të mund të ndjekë të njëjtin rrugëtim drejt BE-së si të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Në deklaratë thuhet se në përputhje me perspektivën europiane të vendit, Komisioni propozon nisjen e studimit të fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Stafi i EuroSpeak, shkurt 2012



Burrat po u drejtohen gjithnjë e më shumë klinikave estetike

Në vitet e fundit, gratë në klinikat estetike ndajnë dhomën e pritjes me burrat. Sipas mjekëve, burrat që kërkojnë ndërhyrje estetike nuk duan të duken bukur, vetëm “më të ri dhe më pak të shqetësuar”. Zakonisht, ata preferojnë t’ju injektohet Botox, një toksinë që ngrin muskujt, shtrin rrudhat e ballit të cilat shfaqen tek njerëzit mbi 40 vjeç, veçanërisht nëse ata kalojnë tërë ditën para një ekrani kompjuteri. Trajtimet të tjera të preferuara janë lazeri dhe produkte kozmetike që zvogëlojnë rrudhat e thella mes hundës dhe gojës. Me sa duket, francezët i frekuentojnë këto klinika me



gratë, ndërsa britanikët preferojnë të përballen me këto trajtime të vetëm. Sipas Shoqatës Amerikane të Kirurgëve, Botoxi është përdorur 336 834 herë nga burrat amerikanë në vitin 2010, 9 për qind më shumë krahasuar me vitin 2009. Por gratë kanë ende 15 herë më shumë gjasa sesa burrat që ta ngrijnë fytyrën duke e përdorur atë. Edhe perkujdesja më pak invazive është në rritje tek meshkujt. Mintel një kompani për studimin e tregut, thotë se shitja e produkteve të bukurisë për meshkuj në Britani, Francë, Gjermani, Spanjë dhe Itali është rritur me 8 për qind gjatë viteve 2005 - 2010, pavarësisht krizës ekonomike, dhe do të rritet me 8 për qind të tjera deri në vitin 2014. Kremrat ushqyese dominojnë në Britani, Francë dhe Spanjë. Ndërsa gjermanët dhe italianët preferojnë të blejnë deodorante.

The Economist, 11 shkurt 2012

Jeta pas vdekjes: Numri i dhuruesve të organeve në BE duhet të rritet

Në Britani, ka nisur një debat i fortë mbi mënyrat si duhet të nxitet dhurimi i organeve. Çdo vit, në këtë vend vdesin rreth 1,000 njerëz për shkak të mungesës së një transplantit. Lista aktive e pritjes përmban rreth 7,600 persona, por shifra 10,000 mund të jetë një pasqyrim më i drejtë i nevojave. Dhurimet e organeve nga persona që humbin jetën janë dy herë më të shumta në vende si Spanja apo Portugalia dhe mesatarja e BE-së përgjithësisht është më e lartë se ajo britanike.

Në grupin e vendeve me dhurim të lartë bëjnë pjesë dhe Shtetet e Bashkuara, Franca dhe Norvegjia. Por përse ndeshet kjo diferencë? Për shumë specialistë, përgjigja qëndron në faktin se Britania ka një sistem "opt-in" regjimi të pëlqimit të informuar, pra dhuruesit potencialë duhet të vendosin të përfshihen në Regjistrin Zyrtar të Donatorëve të organeve. Edhe pse 90 për qind e britanikëve thonë se e miratojnë në parim dhurimin e organeve, në praktikë vetëm 30 për qind kanë nënshkruar për tu bërë pjesë e regjistrit. Spanja, si dhe shumica e anëtarëve të BE-së aplikojnë një formë pëlqimi të supozuar, sipas të cilës të gjithë supozohen të jenë dhurues dhe ata që nuk duan të jenë të tillë duhet ta deklarojnë këtë shprehimisht, "opt-out". Shoqata Mjekësore Britanike (BMA) e

cila përfaqëson mjekët, kërkoi ndërrimin e sistemit. Ndërkohë, në Britani po zhvillohet një fushatë për të inkurajuar dhuruesit e organeve. Pengesat kryesore mendohen të jenë kulturore, edhe pse në teori asnjë nga fetë e mëdha nuk e ndalon dhurimin e organeve, por mund të jetë gjithashtu edhe një çështje besimi tek sistemi i shëndetësisë.

Burimi: Economist Daily Chart

Gjuhë të panumërta

Përkundër idesë se në Amerikë flitet anglisht, në Kinë kinezçe, dhe në Rusi rrusisht, shumica e botës është shumë më e larmishme nga ç'sugjeron prania e gjuhëve të mëdha kombëtare. Në fakt, vendet njëgjuhëshe janë të vështira për tu gjetur. Amerika, Rusia, Brazili, Kina dhe Meksika kanë mbi 100 gjuhë secila, por tregojnë rezultat relativisht të ulët në indeksin e larmisë së gjuhëve. Kjo sepse gjuhët angleze, ruse, portugeze, kineze dhe spanjolle janë rritur deri në pikën sa të kërcënojnë me shkatërrim shumë gjuhë të vogla vendase (autoktone). Vendet që karakterizohen nga një larmi e lartë gjuhësh të folura janë Guinea e Re Papua (rreth 830), Kongo (rreth 215), India (rreth 438), Nigeria (514), Indonezia (719), dhe Meksika (291). Një vend ku flitet një gjuhë e vetme është Koreja e Veriut

Burimi: Economist Daily Chart

Facebook, një superfuqi botërore...

Facebook i shpjeguar në shifra shpalos disa aspekte mjaft interesante. Së pari, përllogaritet që për nga numri i anëtarëve, Facebook numëron një "popullsi" prej 840 milionë, duke u bërë kështu vendi i tretë më i madh në kontinent, pas Kinës dhe Indisë. Për nga vlera në treg, ai renditet pas Apple, Google, Toyota dhe Mc Donalds. Edhe më poshtë renditet për nga numri shumë i kufizuar i punonjësve, vetëm rreth 3.000 persona. Analistët gjykojnë se përdoruesit e faqes faktikisht veprojnë si të punësuar, duke shtuar përmbajtje dhe vlera për të tjerët. Themeluesi i Facebook, Mark Zuckerberg mendohet të jetë tashmë personi më i pasur në botë në proporcion me moshën.

Burimi: Economist Daily Chart



Shpërbërja e kombeve: Rend dhe kaos në shekullin e njëzet e një



Biblioteka e Studimeve Europiane dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, përkthyer dhe botuar nga shtëpia botuese “Dudaj”, me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri

Në vazhdim të kryeveprave të marrëdhënieve ndërkombëtare të sjella në shqip, Bibliotekës së Studimeve Europiane dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë EMA-s, si dhe librarive shqiptare u shtohet një ndër botimet më me influencë publikuar gjatë dekadës së kaluar, **“Shpërbërja e Kombeve: Rend dhe kaos në shekullin e njëzet e një”**.

Në këtë libër, autori Robert Cooper, një ndër diplomatët më të rëndësishëm të Europës, aktualisht Këshilltar i Shërbimit të Jashtëm të BE-së si dhe ndërmjetësues i dialogut Kosovë – Serbi, paraqet interpretimin e tij radikal të një rendi të ri botëror që ka dalë nga mbeturinat e komunizmit. Ai përcakton se të gjitha shtetet sot në botë i përkasin një ndër tre ndarjeve: Shtete “para moderne” ku mungojnë ligjet; shtete “moderne” që janë mbrojtës të flaktë të sovranitetit të tyre; dhe shtete “post-moderne” që veprojnë në bazë të ligjit, transparencës dhe sigurisë të ndërsjellë. Cooper tregon se Shtetet e Bashkuara duhet ende të vendosin nëse do të përqafojnë botën “post moderne” apo do ndjekin unilateralizmin dhe politikën e forcës. Pyetja kyçe me të cilën përballen europianët është nëse në ditët tona është i pranueshëm përdorimi i metodave të ashpra të një epoke më të hershme – të tilla si forca, sulmi parandalues, mashtrimi – në mënyrë që të mbrojnë atë që ata kanë arritur deri më tani. Shpërbërja e kombeve është një përshkrim thelbësor i kohës në të cilën jetojmë. Sugjerohet të lexohet nga çdo politik-bërës, analist, politikan, student, gazetar dhe të gjithë ata që janë të interesuar mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të shekullit të njëzet e një.

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballlet Shqipëria në rrugën drejt integritit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Ndonëse pranohet gjerësisht se integrimi në BE është një prioritet kombëtar, opinionin publik ende mbetet përgjithësisht i painformuar. Kjo situatë shqetësuese mund të shpjegohet jo vetëm nga kompleksiteti i procesit, por edhe nga fakti që shpesh informacioni dhe analiza mbi BE-në nuk ofrohet nga ekspertët, por jepet kryesisht nga politika. Për të nxitur një debat sa më të informuar mbi stadin e reformave të integritit në Shqipëri, EMA po zbaton projektin “Shtjellimi i Procesit të Integritit Europian”, mbështetur nga Ambasada Britanike në Shqipëri.

Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në sitin e Lëvizjes Europiane në Shqipëri. Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: info@em-al.org.

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org



Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e
Ambasadës Britanike në Shqipëri

